

# INFORMACION PËR PRINDËRIT



LAND  
OBERÖSTERREICH

## Të dashur prindër,

Drejtoria për çështjet shoqërore, sociale dhe të shëndetit  
Departamenti i shëndetit

në institucionin e komunës suaj është/janë sëmurë një fëmijë/fëmijë me zgjebe. Zgjebja një sëmundje lëkure ngjitëse e njerëzve që shkaktohet nga këpushat e zgjebes. Veçanërisht aty ku njerëzit jetojnë së bashku në hapësirë të ngushtë mund të përhapen këpushat. Prandaj mund të shfaqen një grup rastesh sëmundjeje, kryesisht në institucione të komunitetit. Forma e zakonshme e zgjebes mund të transmetohet nëpërmjet kontaktit të ngushtë me lëkurën përgjatë një kohe prej minimumi 5-10 minutash (p.sh. fjetja e përbashkët në një krevat, përkëdhelja, mëkimi, përkujdesja e trupit të fëmijëve të vegjël/të sëmurëve) (shtrëngimi i dorës nuk mjafton!). Ndhmoni për të zbuluar të gjithë fëmijët e infektuar, sepse vetëm në këtë mënyrë ndalohej shpejt qarkullimi i sëmundjes. Mund të prekë këdo, edhe personat e pastër, prandaj nuk duhet të kini turp të kotë!

## Çfarë duhet të mbajë parasysh një person kontakti?

### Unë kam pasur kontakt të NGUSHTË:

Nëse ju/fëmija juaj keni/ka pasur në kontakt të ngushtë me një person me zgjebe, ju/fëmija juaj mund të transmetoni/transmetojë këpusha të zgjebes te personat e tjerë edhe para se të ndihet simptoma (koha ndërmjet infeksionit deri në shpërthimin e sëmundjes është 2-6 javë). Prandaj duhet të kryhet një ekzaminim nga mjek. Ai vendos nëse duhet të rekomandojë menjëherë një terapi parandaluese.

### Unë NUK kam pasur kontakt të NGUSHTË:

Ju/fëmija juaj, në mënyrë . duhet të hiqni/heqë dorë nga kontakti intensiv me lëkurën për rreth 5-6 javë  
parandaluese: . duhet të shikohen, gjatë kësaj kohe, simptoma dhe  
. në shenjat e para për një infektim me këpushat e zgjebes, duhet të kërkoni menjëherë një mjek.

Në situara të shpërthimit të sëmundjes mund të bëhet e nevojshme, që për TË GJITHË personat e kontaktit dhe pjesëtarët e tyre të familjes, të kryhet një ekzaminim mundësisht i menjëhershëm ose një trajtim mjekësor parandalues.

## Cilat simptoma ndodhin në rastin e një sëmundjeje?

Djegje e lëkurës dhe kruajtja intensive (madje edhe në vende të painfektuara), që është veçanërisht e theksuar në ngrohtësinë e krevatit gjatë natës, shpesh janë shenjat e para të sëmundjes. Këpusha preferojnë zona të ngrohta të lëkurës, p.sh. midis gishtërinjve dhe këmbëve, nën sqetull dhe ijë dhe në regjionin anal ose gjenital. Ndryshime karakteristike të lëkurës: skuqe lëkure, flluska, nyje dhe/ose varra. Kruarja mund të vazhdojë edhe disa javë edhe pas trajtimit të suksesshëm.

## Çfarë duhet të bëni nëse ju ose fëmija juaj shfaqin simptoma?

Kërkoni menjëherë një mjek dhe njoftoni institucionin e komunitetit dhe mjedisin tuaj (familjen, personat me të cilët jetoni, infermierët). Zgjebja nuk shërohet vetë. Trajtimi kryhet duke vendosur nga jashtë një krem ose duke marrë një tabletë ose të dyja. Rekomandohet të bëhet dush para trajtimit (dhe pastaj të thahet mirë lëkura!) dhe të priten thonjtë. Në përgjithësi, kremi aplikohet nga qafa deri poshtë në të gjithë trupin. Koka dhe fytyra mund të lihen pa u lyer, përveç se nëse është infektuar edhe atje lëkura.

Duhet të mbahen parasysh masat e mëposhtme higjienike:

- ✓ Çdo 12-24 orë ndryshim i veshjeve të brendshme, çarçafëve dhe batanijeve
- ✓ ndërroni peshqirët 2x në ditë

- ✓ Lani rrobat, lirin e shtratit, peshqirët dhe sendet e tjera me kontakt të zgjatur të trupit në minimumi 60 °C për të paktën 10 minuta ose, p.sh. trajtojeni me ndihmën e një pajisjeje me avull të nxehtë
- ✓ Nëse kjo nuk është e mundur → paketoni sende dhe rrobat tekstile në qese plastike dhe ruajini të paktën 21 °C për 72 orë. Në mënyrë alternative, sendi mund të ruhet në -25 °C
- ✓ Tapiceritë, jastëkët e divanit ose mbulesat e dyshemeve të tekstilit (nëse i sëmuri është ulur mbi to me lëkurë pa rroba) mund të fshihen me një fshesë me korrent të fortë (hidhni filtrin dhe qesen më pas) ose nuk përdoren për të paktën 48 orë
- ✓ Sendet me të cilat pacienti kishte kontakt të shkurtër nuk duhet të trajtohen

## A duhet qëndrojë në shtëpi fëmija im për shkak të zgjebes?

Një person i infektuar nga zgjebja (fëmija/stafi) duhet të përjashtohet nga institucioni i komunitetit. Para se të kthehet në institucionin e komunitetit, personi i sëmurë duhet të paraqesë një konfirmim nga mjeku në lidhje me vizitën mjekësore që ka ndodhur dhe trajtimin e duhur nga prindërit në institucionin e komunitetit. (Shtojca 2).

---

 Vula e institucionit

# VËRTETIM

## për institucionin e komunitetit

(shkollë, kopsht grupi 1, kopshtet, çerdhet)

Lutemi, plotësoni këtë vërtetim dhe dorëzojani drejtoreshës/drejtorit të institucionit, nëse fëmija viziton sërish pa zgjebe institucionin e komunitetit pas kontrollit dhe, nëse nevojitet, pas trajtimit.

---

 Emri i fëmijës

Vini një kryq ku është me vend:

Fëmijës tim **NUK** iu gjetën këpusha zgjebeje:

- Unë e kam lexuar informacionin për prindërit zgjebja
- Fëmija im është ekzaminuar nga një mjek.
- Është rekomanduar dhe kryer saktë një terapi profilaktike me (emri) .....
- Meqenëse sëmundja mund të transmetohet te personat e tjerë edhe para se të ndihen simptoma, do të heqim dorë nga kontakti intensiv me lëkurën për rreth 5-6 javë dhe në këtë kohë do të shohim mirë për shenjat e para të një këpushe zgjebe dhe do të kërkojmë menjëherë një mjek.

Fëmijës tim iu **gjetën** këpusha zgjebeje:

- Unë i kam bërë fëmijës tim një trajtim fillestar me preparatin (emri)..... dhe do ta përsëris trajtimin nëse do të rekomandohet nga mjeku im.
- Pas trajtimit me sukses do ta kontrolloj fëmijën tim edhe për 5-6 javë 2x/javë për këpusha.
- E gjithë familja u kontrolluara nga mjeku për këpusha zgjebeje dhe, nëse nevojitet, u trajtua. E gjithë familja do të kontrollohet 5-6 javë 2x/javë për këpusha dhe nëse ka sërish infektim do të përsëritet trajtimi.

---

 Data

---

 Nënshkrimi i prindërve/kujdestarëve ligjorë